



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:112510

Datë: 20.02.2020

Numri i dokumentit: 00842317

P.nr.1022/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurve R.H. nga P., rr. "... " p.n, dhe K.I. nga P., rr. "... " për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2912-12/2011 të dt.29.09.2016, më datën 19.02.2020 mbajti shqyrtimin e dytë gjyqësorë publik në praninë e Prokurorit të shtetit Zef Prendrecaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të pandehurit R.H., pas përfundimit të shqyrtimit dytë gjyqësorë të njëjtën ditë, gjykata mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

R.H., nga babai B., dhe nënës R., e vajzërisë Q., i lindur më dt. *data e lindjes...*, nga P., rr. "... " p.n ku edhe tani jeton, me numër personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike sociale, Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

K.I., nga babai I. dhe nënës M. e vajzërisë K., i lindur më dt. *data e lindjes...*, nga P., rr. "... " ku edhe tani jeton, me numër personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, punëtorë ndërtimtarie, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike sociale, Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

Me datë 23.12.2010, në fshatin B., Komuna e P., të pandehurit R.H., dhe K.I., me qëllim që vetës apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, derisa i dëmtuari B.H. nuk gjendej në shtëpi, i dyshuari i parë kishte depërtuar përmes një dritare nga kati i parë përdhesë të shtëpisë dhe nga lokalet e shtëpisë kishte vjedhur : një studio Sony, një pal dylbi teleskopike me këmbë, një jakne të zezë, një aparat digjital Sony, një TV Plazma dhe një TV Sony, një shporet elektrik, një DVD Philips, një palë patika NIKE, një palë këpucë dhe një palë dorëza për motor ku më pas i pandehuri K.I., duke i kontribuar thellësisht kryerësit të pandehurit R.H. që ti fsheh dhe ruaj mallrat e vjedhura në atë mënyrë që të njëjtat i ka bartuar me veturën e tij dhe i ka fshehur këto mallra ne shtëpinë e agjës së tij, e cila ishte e pa banuar dhe më pas me urdhër të pandehurit të parë të njëjtat edhe i ka shitur, e që sipas të dëmtuarit vlera e sendeve të vjedhura është rreth 1,200 Euro,

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 6,11, 34,35,36, 38, 64, 65, 66 dhe 67 si dhe nenit 253 par.1 pika 1 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, i:

G J Y K O N

Të pandehurin **R.H.**, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin **K.I.**, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 38 par.3 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurve, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, iu zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **1000 €uro** (njëmijë euro), të cilin dënim duhet ta paguajnë në tri kiste mujore brenda afatit prej 3 (tre) muajsh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse të pandehurit nuk e paguajnë dënimin me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgim ashtu që për çdo 15 euro të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burgim.

Detyrohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale secili veq e veq të paguaj sipas listës përfundimtare të shpenzimeve të shkaktuara të gjykatës, kurse për shpenzimet paushallë gjyqësorë secili veç e veç të paguajnë shumën nga **30 €uro**, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohen të pandehurit që në emër të kompensimit të viktimave të paguajnë secili veç e veç shumën nga **30 euro** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B.H. nga fshati B., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.2912-12/2011 të dt.29.09.2016, ka akuzuar të pandehurit R.H. nga P., rr. "...” p.n, dhe K.I. nga P., rr. "...” për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.15.01.2020 ndërsa shqyrtimin e dytë më datë 19.02.2020 gjatë së cilës u dëgjjuan Prokurori i shtetit Zef Prendrecaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të pandehurit R.H. dhe K.I.

I pandehuri K.I., në seancën e shqyrtimit fillestar më datën 15.01.2020, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka theksuar se me vjen keq për rastin, kam qenë shumë i ri në atë kohë, sendet e vjedhura i ka marë policia, i premtoj gjykatës se nuk do të kryej asnjë vepër penale, ndërsa kërkoj falje publikisht gjykatës dhe të dëmtuarit, e lus gjykatën që të më shqiptoi dënim sa më të lehtë.

I pandehuri R.H. gjatë shqyrtimit fillestar më datë 15.01.2020 nuk e ka pranuar fajësisinë ndërsa gjykata ka caktuar shqyrtimin e dytë për datën 19.02.2020.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri K.I. gjatë shqyrtimit fillestar e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht me liri të plotë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajit nga ana e të pandehurit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit K.I., si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por i ka njoftuar palët në procedurë se shpalljen e aktgjykimit do ta bëjë pas shqyrtimit gjyqësorë ndaj të pandehurit R.H.

I pandehuri R.H. në shqyrtimin e dytë më datë 19.02.2020 ka deklaruar se e pranoj fajin më vjen keq që e kam kryer këtë veprë penale i kërkoj falje gjykatës dhe të dëmtuarit unë jam penduar shumë për veprën që e kam kryer e kisha lutë gjykatën që të më shqiptoi një dënim me kusht, i premtoi se nuk do të përsëris vepra penale, tani jam martuar kam krijuar familje.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri R.H., gjatë shqyrtimit të dytë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht me liri të plotë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajit nga ana e të pandehurit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por vetëm ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarve, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale kështu që të njejtit janë penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të pandehurit, gjatë shqyrtimit fillestar përkatsisht shqyrtimin e dytë e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, ndiejnë shumë keqardhje për veprimet e tyre, për të cilat i kërkojnë falje gjykatës dhe të dëmtuarit, premtimin dhënë gjykatës se nuk do ta kryejnë apo përsërisin veprën penale, moshën e tyre të re në kohën e kryerjes së veprës penale, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penal-juridike, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 par.1 të KPK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Gjykata duke u bazuar në nenin 65, nenin 66 dhe nenin 67 par.1 nën par.5 dhe par.2 të KPK-së, ka zbatuar dispozitat për zbutjen e dënimit, ngase të pandehurit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestarë, kanë shprehur keqardhje për veprën që e kanë kryer si dhe kanë premtuar se nuk do ta përsërisin veprën penale apo vepra tjera, i kanë kërkuar falje të dëmtuarit dhe gjykatës, andaj të gjitha këto tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 38 par. 3 të KPK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 39 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave është marrë në bazë të nenit 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për kompenzimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
P.nr.1022/2016 më dt.19.02.2020

Gjyqtari;
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.